



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrasnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike / Kosovska Akademija za Javnu
Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
PËR ZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK

Fakulteti:	Fakulteti i Sigurisë Publike
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi:	Psikologjia e përgjithshme, Psikologjia e stresit, Stresi dhe incidentet kritike në zbatimin e ligjit, Teknikat e këshillimit psikologjik
Kandidatët e paraqitur:	1. Armen Mustafa 2. Anita Zenuni 3. Albina Koliqi - Musliu

Komisioni vlerësues:

1. <u>Kryetar</u>	Prof. Ass. Dr. Dashamir Bërxulli
2. <u>Anëtar</u>	Prof. Asoc. Dr. Lulzim Dragidella
3. <u>Anëtar</u>	Prof. Ass. Dr. Shemsi Krasniqi

Shënimet për kandidatin për të cilin shkruhet raporti *

Kandidati 1.

Emri dhe mbiemri:	Armen Mustafa
Datëlindja dhe vendlindja	01.06.1073
Grada shkencore:	Dr.
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje):	-
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje)	-
Universiteti/Fakulteti/Departamenti	-
Arsimimi i Lartë	
Studimet themelore - Universiteti, Fakulteti, Departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Dega e Pedagogjisë, Profesor i Pedagogjisë, 31.10.2002, 8.00
Studimet master / magjistraturë - Universiteti, Fakulteti, Departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare (për kandidatët e Mjekësisë edhe specializimi nga fusha përkatëse)	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Master në Arsimin Gjithëpërfshirës – Edukimi me Nevoja të Veçanta, 01.11.2008, 9.00
Studimet e doktoratës - Universiteti, Fakulteti, Departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Doktor në Psikologji, 2017, Shumë mirë.

**Të shtohen tabela varësisht nga numri i kandidatëve*

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe e numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore (në këtë pjesë të raportit shënohen publikimet më të rëndësishme të kandidatit bazuar në CV-në e tij).

Veprimtaria shkencore e kandidatit	Numri i publikimeve	
	Nga fillimi i karrierës	Në 4 vjetët e fundit (për asistentët në 3 vjetët e fundit)
Publikimet shkencore në revistat me "impact faktor" si autor kryesor*		
Publikimet shkencore në revistat me "impact faktor" si koautor		
Publikimet shkencore në revistat pa "impact faktor" si autor kryesor		3
Publikimet shkencore në revistat pa "impact faktor" si koautor		
Publikimet në kongreset ndërkomb. Si "proceedings"; autor kryesor		
Publikimet në kongreset ndërkombëtare si "proceedings"; koautor		
Ligjërata në konferenca dhe në universitete të BE (si ligjërues i ftuar)		
Publikimet në revista të tjera shkencore të publikuara në Kosovë		1
Publikimet në revista të tjera shkencore të publikuara në rajon		
Abstraktet nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor		2
Abstraktet nga konferencat shkencore ndërkombëtare si koautor		

Monografitë shkencore si autor kryesor		
Monografitë shkencore si koautor		
Librat me studime si autor kryesor		
Librat me studime si koautor		
(Kontribute të tjera shkencore dhe artistike)		

***Autor kryesor** konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve ose është i shënuar si autor korrespondent i punimit me recension ndërkombëtar.

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 1.

Kandidati Mustafa ka një sërë botimesh të paraqitura. Po ashtu, ka paraqitur edhe certifikatat e pjesëmarrjes në dy edicione të Javës së Shkencës në Kosovë (2014 dhe 2015), në të cilat specifikohen temat e paraqitura. Sidoqoftë, Komisionit Vlerësues nuk i janë vënë në dispozicion materialet përkatëse.

Punimet relevante të kandidatit*

Tabela 2. Punimet shkencore ose të arriturat artistike të kandidatit, të cilat e tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar

Të dhënat për punimet:		"Impact factor"	Pa "Impact factor"	Nr. i citimeve
Autorët / Titulli / Revista / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet				
1.	Armen Mustafa. Impact of domestic violence in the manifestation of aggressive behavior among adolescent aged 15. European Journal of Social Sciences Education and Research,		✓	
2.	Armen Mustafa. Violence Against Children at Home and Family in Kosovo Society. the Prevalence, Types and Perpetrators of Violence. European Journal of Social Sciences Education and Research. Sep – Dec. 2016, Vol.8 Nr. 1		✓	
3.	Armen Mustafa, The impact of socio-economic factors on violence against children in the family. Beder Journal of Humanities, Spring 2017, Issue 7.		✓	
4.	Armend Mustafa, Gazmend Tahiraj. Ngacmimi mes nxënësve të klasave të pesta të shkollës fillore dhe masat parandaluese. Thesis. AAB. 2014. Volumi 3, numri 2.		✓	

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 2.

Kandidati Mustafa ka një aktivitet publikues të një dimensionit të caktuar. Të paktën një punim i tij është në një revistë, që gjendet në listën e punimeve të dyshimta të Beall-it. Padyshim vetë botimi nuk nënkupton, që punimi nuk është i vlefshëm, sepse nuk mund t'u kufizohet individëve botimi në çfarëdo reviste, që konsiderojnë të arsyeshme. Sidoqoftë, përfshirja në aplikim për një pozitë akademike të një artikulli të tillë nuk është më e mira, që një aplikant bën në këto raste. Gjithashtu, pavarësisht vlerës eventuale të botimeve, artikujt e fundit të botuar duket se janë në kuadër të plotësimit të dosjes për mbrojtje të doktoratës.

2. Përvoja në mësimdhënie universitare

Kandidati Mustafa ka përvojë në mësimdhënie në dy institucione të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës: Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (institucion publik i arsimit të lartë) dhe Kolegjin AAB (institucion privat i arsimit të lartë). Nga dokumentet e dorëzuara është e paqartë, se cilat janë lëndët të cilat ligjëron kandidati Mustafa.

3. Përvoja menaxhuese, angazhimet profesionale dhe udhëheqja në hulumtim

Kandidati Mustafa nuk ka paraqitur të dhëna lidhur me përvojën menaxhuese në institucione të arsimit të lartë dhe projekte udhëheqëse në hulumtim. Përsa i përket angazhimeve profesionale, kandidati Mustafa është aktiv në fusha, që kanë të bëjnë kryesisht me formimin e tij të studimeve themelore dhe me ato të politikave sociale.

4. Mobiliteti i kandidatit

Kandidati Mustafa nuk ka sjellë dëshmi për qëndrime lidhur me hulumtime, çështje pedagogjike apo

zhvillim shkencor/profesional. Sidoqoftë, kandidati Mustafa ka doktoruar në Tiranë, prandaj dimensionin e mobilitetit është faktik, paçka se jo esencialisht i spikatur në profilin e tij akademik.

Kandidati 2.

Emri dhe mbiemri:	Anita Zenuni
Datëlindja dhe vendlindja	27.04.1981, Prishtinë
Grada shkencore:	Master
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje):	Ligjëruese
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje)	01.03.2014
Universiteti/Fakulteti/Departamenti	Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Fakulteti i Sigurisë Publike
Arsimimi i Lartë	
Studimet themelore - Universiteti, Fakulteti, Departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Psikologjisë, Baçelor i Psikologjisë, 2004, 8.88
Studimet master / magjistraturë - Universiteti, Fakulteti, Departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Psikologjisë, Master i Psikologjisë – Drejtimi Klinik, 2012, 9.32
Studimet e doktoratës - Universiteti, Fakulteti, Departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare	

**Të shtohen tabela varësisht nga numri i kandidatëve*

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe e numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore (në këtë pjesë të raportit shënohen publikimet më të rëndësishme të kandidatit bazuar në CV-në e tij).

Veprimtaria shkencore e kandidatit	Numri i publikimeve	
	Nga fillimi i karrierës	Në 4 vjetët e fundit (për asistentë në 3 vjetët e fundit)
Publikimet shkencore në revistat me "impact faktor" si autor kryesor*		
Publikimet shkencore në revistat me "impact faktor" si koautor		
Publikimet shkencore në revistat pa "impact faktor" si autor kryesor	2	
Publikimet shkencore në revistat pa "impact faktor" si koautor	1	
Publikimet në kongreset ndërkombëtare si "proceedings"; autor kryesor	1	
Publikimet në kongreset ndërkombëtare si "proceedings"; koautor	1	
Ligjërata në konferenca dhe në universitete të BE (si ligjërues i ftuar)		
Publikimet në revista të tjera shkencore të publikuara në Kosovë		
Publikimet në revista të tjera shkencore të publikuara në rajon		
Abstraktet nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor		

Abstraktet nga konferencat shkencore ndërkombëtare si koautor		
Monografite shkencore si autor kryesor		
Monografite shkencore si koautor		
Librat me studime si autor kryesor		
Librat me studime si koautor		
(Kontribute të tjera shkencore dhe artistike)		

**Autor kryesor konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve ose është i shënuar si autor korrespondent i punimit me recension ndërkombëtar.*

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 1.

Kandidatja Zenuni ka sjellë dëshmi për botime apo pjesëmarrjes në konferenca, të cilat datojnë në një periudhë afatmesme dhe nuk kanë lidhje me kohën si ligjëruese (staf i rregullt) në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Punimet relevante të kandidatit*

Tabela 2. Punimet shkencore ose të arriturat artistike të kandidatit, të cilat e tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar

Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet	"Impact factor"	Pa "Impact factor"	Nr. I citimeve
1. Anita Zenuni, Shemsedin Vehapi, Besim Gashi (2015). The effects of self-esteem, focused learning and valuing of school on academic performance of students. Philosophica Vol. 2. No 3-4/2015, Vol. 2. Tetovë. Maqedoni		✓	
2. Shemsedin Vehapi, Anita Zenuni (2014). Efekti i planifikimit, menaxhimit të kohës, të mësimin dhe të këmbënguljes në arritjet shkollore të nxënësve. Philosophica, Vol.1, No. 1-2. Tetovë. Maqedoni		✓	
3. Anita Zenuni, Shemsedin Vehapi (2013). Adaptive cognitive dimension and maladaptive behavioral dimension as motivating factors in school achievement. Thesis. No. 1. AAB. Prishtinë.		✓	

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 2.

Kandidatja Zenuni në fillimet e karrierës së saj akademike ka pasur një aktivitet më të spikatur akademik, se sa në vitet e fundit. Pavarësisht se bëhet fjalë për botime në revista në fillimet e veta, nisja ka qenë premtuese. Në këtë pikëpamje mund të konkludohet, që kandidatja paraqet një profil hulumtuesje gjithësesi interesant, së cilës i duhet të fokusohet më shumë në punë kërkimore.

2. Përvoja në mësimdhënie universitare

Kandidatja Zenuni është staf i rregullt i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike. Ajo ka dhënë gjithashtu mësim në Kolegjin AAB dhe Fakultetin Filozofik, UP.

3. Përvoja menaxhuese, angazhimet profesionale dhe udhëheqja në hulumtim

Kandidatja Zenuni ka përvojë në menaxhimin e cilësisë në një institucion të arsimit të lartë, ndërkohë që vazhdimisht është e angazhuar në çështje profesionale si në kuptimin e shërbimeve, ashtu edhe në atë të formimit personal.

4. Mobiliteti i kandidatit

Kandidatja Zenuni shkruan, se studion në Universitetin Shën Klementi i Ohrit në Manastir, Maqedoni, gjë që e ka konfirmuar edhe gjatë intervistës me Komisionin Vlerësues. Sidoqoftë, dokumentacioni i pranuar nga Komisioni Vlerësues nuk përmban vërtetimin për një gjë të tillë.

Kandidati 3.

Emri dhe mbiemri:	Albina Koliqi - Musliu
Datëlindja dhe vendlindja	24.12.1984, Tivar, Mali i Zi
Grada shkencore:	Master
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje):	-
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje)	-
Universiteti/Fakulteti/Departamenti	-
Arsimimi i Lartë	
Studimet themelore - Universiteti, Fakulteti, Departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Psikologjisë, Baçelor i Psikologjisë, 15.11.2006, 9.29
Studimet master / magjistraturë - Universiteti, Fakulteti, Departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Psikologjisë, Master i Psikologjisë – Programi Klinik, 12.07.2017, 8.11.
Studimet e doktoratës - Universiteti, Fakulteti, Departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare	

**Të shtohen tabela varësisht nga numri i kandidatëve*

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe e numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore (në këtë pjesë të raportit shënohen publikimet më të rëndësishme të kandidatit bazuar në CV-në e tij).

Veprimtaria shkencore e kandidatit	Numri i publikimeve	
	Nga fillimi i karrierës	Në 4 vjetët e fundit (për asistentë në 3 vjetët e fundit)
Publikimet shkencore në revistat me "impact faktor" si autor kryesor*		
Publikimet shkencore në revistat me "impact faktor" si koautor		
Publikimet shkencore në revistat pa "impact faktor" si autor kryesor		
Publikimet shkencore në revistat pa "impact faktor" si koautor		
Publikimet në kongreset ndërkomb. Si "proceedings"; autor kryesor		
Publikimet në kongreset ndërkombëtare si "proceedings"; koautor		
Ligjërata në konferenca dhe në universitete të BE (si ligjërues i ftuar)		
Publikimet në revista të tjera shkencore të publikuara në Kosovë		
Publikimet në revista të tjera shkencore të publikuara në rajon		
Abstraktet nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor		
Abstraktet nga konferencat shkencore ndërkombëtare si koautor		
Monografite shkencore si autor kryesor		

Monografitë shkencore si koautor		
Librat me studime si autor kryesor		
Librat me studime si koautor		
(Kontribute të tjera shkencore dhe artistike)		

**Autor kryesor konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve ose është i shënuar si autor korrespondent i punimit me recension ndërkombëtar.*

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 1.

Kandidatja Koliqi – Musliu nuk ka paraqitur të dhëna për këtë rubrikë.

Punimet relevante të kandidatit*

Tabela 2. Punimet shkencore ose të arriturat artistike të kandidatit, të cilat e tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar

Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet	"Impact factor"	Pa "Impact factor"	Nr. I citimeve
1.		✓	

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 2.

Kandidatja Koliqi – Musliu nuk ka paraqitur të dhëna për këtë rubrikë.

2. Përvoja në mësimdhënie universitare

Kandidatja Koliqi – Musliu ka paraqitur dëshmi, që ka kontratë si ligjëruese e rregullt në Kolegjin FAMA, dega në Mitrovicë.

3. Përvoja menaxhuese, angazhimet profesionale dhe udhëheqja në hulumtim

Kandidatja Koliqi – Musliu ka angazhime profesionale të spikatura në fushën e trajtimit të traumave, fushë në të cilën ka edhe temën e saj të masterit.

4. Mobiliteti i kandidatit

Kandidatja Mustafa nuk ka paraqitur dëshmi për këtë rubrikë.

5. Përfundimi dhe propozimi (titulli i cili propozohet)

Armen Mustafa nuk propozohet për vendin e punës për të cilin ka aplikuar. Meqenëse lëndët për të cilat ka aplikuar kandidati Mustafa janë të fushës së psikologjisë, Komisioni Vlerësues gjykon, se ligjërimi i tij kërkon një formim më bazik dhe më të plotë në fushën e psikologjisë. Kandidati Mustafa është e vërtetë, se ka titullin Doktor i Psikologjisë, po ashtu mund të ketë pasur lëndë të caktuara nga fusha e psikologjisë në kuadër të studimeve të tij bazike (pedagogji) dhe ato master (edukim inkluziv); por ato nuk mund gjithsesi të ndërtojnë, të paktën jo për një kohë të shkurtër dhe jo pa u marrë në mënyrë të përditshme me të, një profil profesional të psikologut të mirëfilltë. Kandidati Mustafa ka treguar afinitet ndaj çështjeve interdisciplinare dhe kjo është padyshim një vlerë e tij. Por në rastin, kur kandidohet për një vend pune, i cili vendos në qendër të kërkesave profilin profesional të psikologut të etabluar që në studime bazike më pas në ato master dhe doktoraturë, imponohet një formim konsektiv pikërisht i fushës së psikologjisë. Gjithashtu, Komisioni Vlerësues nuk vlerëson faktin, që kandidati Mustafa nuk është paraqitur në intervistën e organizuar me aplikantët, gjë që do të ishte një mundësi e mirë për të parë dhe sqaruar në intervistim dilemat, disa nga të cilat u përmendën edhe më lart.

Anita Zenuni propozohet në thirrjen Ligjëruese meqenëse plotëson të gjitha kushtet dhe kërkesat e nenit 23, pika 1, nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores për Arsimin e Lartë në AKSP. Kandidatja Zenuni ka shkëlqyer, krahasimisht, edhe në intervistën para Komisionit Vlerësues. Në fund, vlerësimet pozitive të dhëna nga institucioni, ku punon (AKSP), përforcojnë zgjedhjen e Komisionit Vlerësues për kandidaten Zenuni si kandidatja më e përshtatshme për vendin e punës nr. 7.


Albina Koliqi – Musliu nuk propozohet për vendin e punës për të cilin ka aplikuar. Kjo kandidatë me një përvojë të vlefshme në fushën e psikoterapisë së traumës. Gjithashtu, të dyja nivelet e studimit (BA dhe MA) i ka në fushën përkatëse (të psikologjisë). Sidoqoftë, kandidatja Koliqi – Musliu është e rëndësishme të profilizohet në fushën e hulumtimeve, meqenëse karriera akademike kërkon një komponent të tillë të rëndësishëm. Gjithashtu, edhe intervista e Komisionit Vlerësues me kandidaten Koliqi – Musliu reflekton idenë, se kandidatja mund të bëjë një kombinim të mirë mesimdhënëseje praktikuese të profesionit. Sidoqoftë, në këtë fazë shihet nevoja për më shumë investim kohe dhe energjie në hulumtime shkencore dhe mesimdhënie.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:

1. Kryetar

2. Anëtar

3. Anëtar



The image shows three handwritten signatures in blue ink, each written on a horizontal line. The first signature is the most prominent and appears to be 'D. ...'. The second signature is 'F. ...'. The third signature is 'M. ...'. The lines are horizontal and extend across the width of the page.